

**SHOQËRIA ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT  
RAIFFEISEN - RAIFFEISEN PENSION FUNDS  
MANAGEMENT COMPANY SH.A.**

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

**DHE PASQYRAT FINANCIARE**

**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2010**

## **PASQYRA PËRMBLEDHËSE**

	<b>Faqe</b>
<b>Raporti i auditorit të pavarur</b>	
<b>Pasqyrat Financiare</b>	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave	2
Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit	3
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	4
Shënimet mbi pasqyrat financiare	5-30

## **RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

**Aksionarëve dhe Drejtimit të Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a.**

### ***Raporti mbi Pasqyrat Financiare***

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a. (“Shoqëria”) bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### ***Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare***

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

### ***Përgjegjësia e Auditorit***

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

### ***Opinionit***

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a. më 31 dhjetor 2010 si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### Tërheqje vëmendje

Ne tërheqim vëmendjen te Shënimi 2 (e) i pasqyrave financiare që përshkruan se për shkak të pasigurisë në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta të Shoqërisë Administruese dhe Fondit që ajo manaxhon më datën e përgatitjes dhe aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, pasqyrat financiare bashkëngjitur përfshijnë pozicionin financiar dhe rezultatin e veprimtarisë së Shoqërisë Administruese dhe Fondit. Opinioni ynë nuk modifikohet lidhur me këtë çështje.

*Deloitte Albania shpk*

Deloitte Albania sh.p.k  
30 mars 2011

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
<b>AKTIVI</b>			
Aktive afatgjata materiale	6	2,547,074	584,262
Aktive afatgjata jomateriale	7	7,376,615	181,175
Letra me vlerë të tregtueshme	8	108,387,158	85,913,641
Parapagime dhe të arkëtueshme	9	41,520	22,356
Tatim fitimi i parapaguar		243,751	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj	10	2,838,955	5,510,309
<b>TOTALI I AKTIVIT</b>		<b>121,435,073</b>	<b>92,211,743</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar	11	90,000,000	90,000,000
Rezervë ligjore	12	1,000,000	-
Humbje të mbartura		(37,209,807)	(53,911,798)
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>53,790,193</b>	<b>36,088,202</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Fondi i pensionit	13	66,261,587	53,215,538
Tatim fitimi i pagueshëm		-	1,640,356
Detyrime të tjera	14	1,383,293	1,267,647
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>67,644,880</b>	<b>56,123,541</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>121,435,073</b>	<b>92,211,743</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen - Raiffeisen Pension Funds Management Company Sh.a më 8 mars 2011 dhe u firmosën nga:



Administratore e Përgjithshme

Majlinda GJATA





Zv. Administratore e Përgjithshme

Gentiana GJONÇA



Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Të ardhurat nga letrat me vlerë, neto	15	5,366,384	2,858,089
Të ardhurat nga komisionet e anëtarësimit		22,800	23,800
Të ardhurat nga transaksionet, neto	16	34,433,817	32,136,408
		<b>39,823,001</b>	<b>35,019,317</b>
Shpenzime për personelin	17	(14,658,202)	(9,514,551)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7	(598,569)	(374,092)
Shpenzime të përgjithshme administrative	18	(4,068,107)	(4,466,708)
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata		-	(423,427)
		<b>(19,324,878)</b>	<b>(14,778,778)</b>
(Humbja) / fitimi i porealizuar nga letrat me vlerë		(769,728)	1,132,998
(Humbja) / fitimi nga kursi i këmbimit		(41,359)	1,020
<b>Fitimi neto para tatimit</b>		<b>19,687,036</b>	<b>21,373,537</b>
Tatim fitimi	19	(1,985,045)	(2,150,354)
<b>Fitimi neto pas tatimit</b>		<b>17,701,991</b>	<b>19,223,183</b>
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave përmbledhëse</b>		<b>17,701,991</b>	<b>19,223,183</b>

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds  
Management Company sh.a**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

---

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Rezerva Ligjore</b>	<b>Humbje të mbartura</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2008 (ndryshuar)</b>	<b>90,000,000</b>	-	<b>(73,134,981)</b>	<b>16,865,019</b>
Fitimi i vitit	-	-	19,223,183	19,223,183
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>90,000,000</b>	-	<b>(53,911,798)</b>	<b>36,088,202</b>
Rezervë ligjore	-	1,000,000	(1,000,000)	-
Fitimi i vitit	-	-	17,701,991	<b>17,701,991</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>90,000,000</b>	<b>1,000,000</b>	<b>(37,209,807)</b>	<b>53,790,193</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
<b>Rrjedhja e parasë nga aktiviteti operacional</b>		
Fitimi para tatimit	<b>19,687,036</b>	<b>21,373,537</b>
<i>Rregullime për:</i>		
Të ardhurat nga letrat me vlerë	(39,800,201)	(34,994,497)
Humbja nga nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve afatgjata	-	423,427
Zhvlerësimi dhe amortizimi	598,569	374,092
	<b>(19,514,596)</b>	<b>(12,823,441)</b>
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>		
Rritje në letrat me vlerë të tregtueshme	(20,359,086)	(36,219,475)
Rritje në kontribute	13,046,049	17,374,752
(Rritje) / pakësim në parapagime dhe të arkëtueshme	(19,164)	775,958
Rritje në detyrime të tjera	115,647	888,080
	<b>(26,731,150)</b>	<b>(30,004,126)</b>
Tatim fitimi i paguar	(3,869,150)	-
Interes i arkëtuar	37,685,768	34,228,792
<b>Rrjedhja e parasë neto e gjeneruar në aktivitetin operacional</b>	<b>7,085,468</b>	<b>4,224,666</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga investimet</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(2,516,094)	(39,344)
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale	(7,240,728)	(50,350)
Të hyra nga shitja e aktiveve të qëndrueshme		657,529
<b>Rrjedhja e parasë neto (e përdorur) / e gjeneruar nga aktivitetet investuese</b>	<b>(9,756,822)</b>	<b>567,835</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitet financuese</b>		
Rritja e kapitalit	-	-
<b>Rrjedhja neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>(Rënia) / rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj</b>	<b>(2,671,354)</b>	<b>4,792,501</b>
<b>Para dhe ekuivalentët e saj në fillim të periudhës</b>	<b>5,510,309</b>	<b>717,808</b>
<b>Para dhe ekuivalentët e saj në fund të periudhës (Shënimi 10)</b>	<b>2,838,955</b>	<b>5,510,309</b>

Pasqyra e rrjedhjes së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet 1 deri në 22 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



# **Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

---

## **1. HYRJE**

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Managements Company sh.a. (“Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shqiptare me seli në Tiranë. Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar me Vendim të Gjykatës së Rrethit, Tiranë Nr. 33825, datë 18 korrik 2005. Zyra qendrore e Shoqërisë është në Bulevardin “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Godina nr. 6, Kati II, Tirana, Albania.

Shoqëria është liçensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më 7 korrik 2005, (Vendimi Nr 2) të operojë si një shoqëri pensionesh në Shqipëri në përputhje me Ligjin Nr. 7943, “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të datës 1 qershor 1995 dhe ndryshuar me ligjin Nr. 8393, datë 2 shtator 1998. Shoqëria ka marrë përsipër të krijojë dhe të drejtojë një fond pensioni vullnetar me kontribut të përcaktuar.

Emri ligjor i Shoqërisë ka qenë: “Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë sh.a” dhe më 23 prill 2009, emri i shoqërisë u ndryshua në “Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.”.

Një ligj i ri Nr.10197, datë 12 dhjetor 2009 “Mbi fondet vullnetare të pensioneve” u aprovua në Parlamentin Shqiptar dhe hyri në fuqi më 15 janar 2010. Ligji i ri përfshin ndryshime të rëndësishme nga praktikat aktuale të fondeve të pensionit me ndryshimin kryesor në ndarjen e shoqërisë manaxhuese dhe fondit të pensionit (duke përfshirë dhe ndarjen e tyre ligjore).

Më 31 mars 2010, Asambleja e Zakonshme e Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë, vendosi ndryshimin e emrit të Shoqërisë nga “Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.”, në “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a”.

Më datë 18 tetor 2010, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i dha Shoqërisë Liçencën Nr.1 datë 18 tetor 2010 duke liçencuar “Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a”, për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Gjithashtu, më 18 tetor 2010, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bazuar në vendimin nr. 107 datë 18 tetor 2010, miratoi “Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen / Raiffeisen Voluntary Pension Fund” nën administrimin e “Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a”.

Sipas Ligjit të ri, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi gjithashtu First Investment Bank Albania sh.a. si bankë depozitare e Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen. Shoqëria administruese dhe depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen.

## **Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

---

### **2. BAZAT E PËRGATITJES**

#### **a) Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

#### **b) Bazat e matjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare për tregtim, të cilat janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes.

#### **c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lek”, e cila është monedha funksionale dhe prezantuese.

#### **d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

#### **e) Fondi i Pensioneve Vullnetare Raiffeisen**

Shoqëria vepron si Shoqëri Administruese e një Fondi Vullnetar me Kontribute të përcaktuara “Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen / Raiffeisen Voluntary Pension Fund” (“Fondi”) i cili, bazuar në ligjin e ri, nuk ka personalitet ligjor dhe nuk mund të rregjistrohet si një Shoqëri më vete. Gjithsesi, kërkesat e ligjit të ri përcaktojnë përgjegjësinë e Shoqërisë për të përgatitur pasqyra të veçanta financiare për Shoqërinë dhe për Fondin.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen ka bërë përgatitjet e duhura për të qenë në përputhje me ligjin e ri duke filluar nga 1 Janari 2011, përfshirë mbajtjen më vete të veprimtarisë dhe të dhënave financiare të Shoqërisë dhe të Fondit. Për të realizuar këtë, një program i ri kompjuterik është blerë me qëllim llogaritjen ditore të parametrave të Fondit siç kërkohet nga ligji i ri.

Si rrjedhojë e pasigurive lidhur me kuadrin rregullator të raportimit dhe në mungesë të politikave apo rregulloreve lidhur me kërkesat për raportim të veçantë të pasqyrave financiare të Shoqërisë dhe të Fondit në datën e përgatitjes dhe aprovimit të pasqyrave financiare, Shoqëria nuk ka përgatitur pasqyra financiare të veçanta më 31 dhjetor 2010 dhe për rrjedhojë aktiviteti dhe aktivet e Fondit janë përfshirë në aktivitetin dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë.

## **Shoqëria Administruese e Fondëve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

---

### **2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)**

#### **f) Fondi i Pensioneve Vullnetare**

Bazuar në ligjin 7943 “Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve”, Fondi i Pensioneve Vullnetare mbledh kontribute nga punëdhënësit dhe individët, ku minimumi i kontributit, i përcaktuar nga ligji është 500 Lek. Fondi është krijuar për të siguruar shërbimin e pensioneve për publikun. Në përputhje me kontratat e nënshkruara me punëdhënësit, ose me individët, përfitimet janë të pagueshme në të ardhmen. Përfitimet përbëhen nga kontributet vullnetare të mbledhura dhe interesi i përfituar nga këto kontribute. Interesi fillon të përlogaritet 15 ditë pas çdo arkëtimi individual.

Kontributet vullnetare të akumuluar janë investuar në bono thesari, obligacione të qeverisë shqiptare dhe është përlogaritur një normë kthimi vjetore. Shuma vjetore e interesit, e cila është shtuar në llogarinë individuale të çdo kontribuesi, është përlogaritur duke përdorur një normë, e cila është më e ulët se norma e kthimit të investimeve (për të realizuar kostot e manaxhimit sipas rregullit 75/25).

Në bazë të Vendimit të Administratorëve të Kompanisë Nr. 717, datë 17 Janar 2011, norma vjetore e përdorur në llogaritjen e interesave të kontribuesve për vitin 2010 është 6,89% (2009: 28,49%).

Interesi i fituar nga anëtarët është kredituar në detyrimet e fondit të pensionit dhe të ardhurat nga interesat dhe nga transaksionet me letrat me vlerë janë prezantuar neto duke zbritur interesat e fituara nga anëtarët e fondit.

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente në këto pasqyra financiare.

**(a) Plani i kontributeve të përcaktuara**

Sipas planit të kontributeve të përcaktuara, shuma e përfitimeve në të ardhmen për një anëtar përcaktohet nga kontributet e paguara si dhe interesat e fituara nga kontributet e investuara.

Detyrimet janë njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e duhur dhe janë paraqitur si interes që i kreditohet fondit të pensionit nga të ardhurat nga investimet.

Shoqëria përfiton të ardhura nga investimet, të cilat llogariten si një pjesë e normës së interesave nga investimet të arritura nga Fondi (shiko shënimin 2). Kjo mesatare përlllogaritet çdo vit për Fondin dhe Shoqërinë. Përveç kësaj, Shoqëria merr një tarifë fillestare prej 200 Lek.

Tarifa fillestare mblihet në hapjen e një llogarie të re personale. Kjo praktikë gjithashtu bazohet në ligjin 7943 “Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve”.

**(b) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të vitit. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës së drejtë. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara (Lek kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2010		31 dhjetor 2009	
	<i>Në fund të vitit</i>	<i>Mesatarja</i>	<i>Në fund të vitit</i>	<i>Mesatarja</i>
Dollari amerikan (USD)	104	103.94	95.81	94.9
Monedha Europiane (EUR)	138.77	137.79	137.96	132.02

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(c) Të ardhurat nga investimet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivitetit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjeve, primeve të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose ç'rregjistrimin e aktivitetit, ose detyrimit financiar.

Të ardhurat nga investimet të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave pasqyrojnë interesin e aktiveve financiare, pasi i janë zbritur interesat që i kreditohen fondit të pensionit (shiko politikën kontabël 3 (a)).

#### **(d) Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative regjistrohen kur ato ndodhin.

#### **(e) Përfitimet e punonjësve**

- *Plan pensioni me kontribute të përcaktuara*

Shoqëria paguan kontribute shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

- *Leja vjetore e paguar*

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

- *Përfitimet afat-shkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi.

Një provigjion mund të regjistrohet për shumën që pritet të paguhet për bonuset afatshkurtra në para, ose planet e pjesëmarrjes në fitime, nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(f) Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi, ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Tatime shtesë mbi fitimin që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet dhe detyrimi për të paguar dividend.

#### **(g) Aktivet dhe detyrimet financiare**

##### *i Regjistrimi*

Të gjitha aktivet dhe detyrimet njihen fillimisht me datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë e kontratës. Në njohjen fillestare aktivet financiare janë përcaktuar si të vlefshme për shitje dhe të matura me vlerën e drejtë plus kosto të transaksionit që i përkasin blerjes, ose emetimit të aktivit financiar.

##### *ii Ç'regjistrimi*

Shoqëria ç'regjiston një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale, ose flukset monetare që rrjedhin nga aktiv i financiar mbarojnë, ose kur i transferon aktivin një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin, ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit.

Shoqëria ç'regjiston detyrimet financiare kur detyrimet e kontraktuara kanë mbaruar, janë shlyer, ose anuluar.

Shoqëria merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit të saj financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk ç'regjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar.

Në transaksionet në të cilat Shoqëria as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, aktiv i ç'regjistrohet nëse kontrolli mbi të humbet.

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

*iii Matja e vlerës së drejtë*

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivet financiare janë matur me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknika të vlerësimit. Metodën e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

*iv Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit*

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

**(h) Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare me shkallë likuiditeti të lartë me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Shoqëria për administrimin e angazhimeve afat-shkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

**(i) Llogaritë e arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar, duke i zbritur zhvlerësimin (sipas shënimit 3 (m)).

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(j) Aktive afatgjata materiale**

- *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë të aktiveve afatgjata materiale.

- *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

- *Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën e vlerës së mbetur. Aktivitetet me qira zhvlerësohen për më të voglën mes periudhës së qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme.

Përqindjet vjetore të zhvlerësimit janë si më poshtë:

<b>Kategoria e aktivitetit</b>	<b>2010</b>	<b>2009</b>
• Pajisje zyre	20%	20%
• Pajisje informatike	25%	25%
• Mjete transporti	20%	20%

#### **(k) Aktive afatgjata jomateriale**

Aktivitetet afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria njihen me kosto historike, zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të këtij aktiviteti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur. Norma e amortizimit vjetor është 25%.



### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(l) Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme janë mbajtur me kosto të amortizuar.

#### **(m) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin apo amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

#### **(n) Provigjionet**

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të mirat ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para taksës e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

#### **(o) Standarde dhe interpretime efektive në periudhën aktuale**

Rishikimet e mëposhtme për standardet ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë të vlefshme për periudhën aktuale:

- **SNRF 1 (i rishikuar) “Aplikimi për herë të parë i SNRF”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **SNRF 3 (i rishikuar) “Kombinimet e Biznesit”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”** – Përjashtimet shtesë për herën e parë të zbatimit. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 2 “Pagesa të Bazuara në Aksione”** – Grup transaksionesh për pagesë aksionesh të shlyer në mjete monetare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(o) Standarde dhe interpretime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)**

- **Rishikimi i SNK 27 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja”** – Artikujt mbrojtës të pranueshëm. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime “Përmirësimet e IFRS-ve (2009)”** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 16 Prill 2009 (SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36, SNK 38, SNK 39, KIRFN 9, KIRFN 16) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (shumica e rishikimeve do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 17 “Shpërndarja e Aktiveve Jo-monetare ndaj Pronarëve”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 18 “Transferimi i Aktiveve nga Klientët”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date), [duke supozuar se një transferim i tillë i aktiveve nuk ka ndodhur në gjysmën e dytë të vitit 2009 dhe se Shoqëria e ka aplikuar KIRFN 18 për herë të parë në 2010].

Aplikimi i këtyre rishikimeve dhe standardeve e interpretimeve ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në politikat e kontabilitetit të Shoqërisë.

#### **(p) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar, por ende jo në fuqi:

- **SNRF 9 “Instrumentet Financiare”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2013 ose pas kësaj date). SNRF 9 “Instrumentet Financiare” u publikua nga BSNK më 12 nëntor 2009. Më 28 shtator 2010, BSNK ri-publikoi SNRF 9, duke shtuar kërkesa të reja mbi kontabilizimin e detyrimeve financiare dhe duke mbajtur nga SNK 39 kërkesat për çrregjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Standardi përdor një metodologji të vetme për të përcaktuar nëse aktivi financiar matet me kosto të amortizuar apo me vlerë të drejtë, duke zëvendësuar rregullat e shumta në SNK 39. Metodologjia e SNRF 9 bazohet mbi mënyrën se si një Shoqëri manaxhon instrumentat financiare (sipas modelit të biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhjes së parasë së kontraktuar të aktivitetit financiar. Standardi i ri gjithashtu kërkon përdorimin e një metode zhvlerësimi, duke zëvendësuar metodat e ndryshme të zhvlerësimit në SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare adresojnë problemin e luhatjeve në fitim humbjet që lindin kur lëshuesi zgjedh ta vlerësojë borxhin me vlerën e drejtë. BSNK vendosi të mbajë vlerësimin aktual me kosto të amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke u kufizuar në ndryshimet e kërkuara për të adresuar problemet e vetë kreditimit. Me kërkesat e reja, Shoqëria që zgjedh të vlerësojë një detyrim me vlerën e drejtë do paraqesë pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë si pasojë e ndryshimeve në rrezikun e kreditimit, në të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 9 e publikuar pasqyron pjesën e parë të punës së BSNK në zëvendësimin e SNK 39 dhe lidhet me klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare të përkufizuara nga SNK 39. Në faza të mëtejshme, Bordi do adresojë zhvlerësimin dhe mbrojtjen [hedge]. Përfundimi i projektit pritet në mes të 2011. Aplikimi i fazës së parë të SNRF 9 kryesisht do ketë efekt në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Shoqëria aktualisht po vlerëson efektin e aplikimit të SNRF 9, gjithsesi, efekti do varet nga aktivitet që do ketë Shoqëria në datën e aplikimit, ndaj aktualisht nuk mund të kuantifikohet efekti.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(p) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara (vazhdim)**

- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Përjashtimet e limituara për shifrat krahasuese sipas SNRF 7; për paraqitjet për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Hiperinflacion i rëndë dhe heqja e datave të përcaktuara për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Paraqitja”** – Transferimi i aktiveve financiare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”** – Taksa e shtyrë: Rimarrja e aktivitet bazë (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2012 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 24 “Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura”** – Thjeshtësimi i kërkesave për paraqitjet e entiteteve të lidhura me qeverinë dhe qartësimi i përkufizimit të palëve të lidhura. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 32 “Instrumentet Financiare: Paraqitja”** – Kontabilizimi i të drejtave për të emetuar (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Shkurt 2010 ose pas kësaj date)
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime “Përmirësimet e IFRS-ve (2010)”** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 6 Maj 2010 (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 7, SNK 1, SNK 27, SNK 34, KIRFN 13) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (rishikimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date ose në 1 Janar 2011 se pas kësaj date në varësi të standardit / interpretimit),
- **Rishikim i KIRFN 14 “SNK 19 — Limiti i Aktivitet për përfitime të përcaktuara, Kërkesat minimale për fonde dhe ndërveprimet e tyre.** – Parapagimet e një minimumi të kërkesës për fonde (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2011 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 19 “Shuarja e Detyrimeve me instrumente Kapitali”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date).

Shoqëria ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon se aplikimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e saj financiare në periudhën e aplikimit fillestar.

#### **4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

##### **(a) Të përgjithshme**

Përdorimi i instrumentave financiare e ekspozon Shoqërinë ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut dhe administrimin e kapitalit të Shoqërisë.

##### ***Struktura e administrimit të rrezikut***

Sipas ligjit nr.10197, datë 12 dhjetor 2009 “Mbi fondet vullnetare të pensioneve” Shoqëria administruese duhet të ketë një strukturë për administrimin e rrezikut. Në strukturën e re organizative, Zëvendës Administratorja e Përgjithshme është përgjegjëse për administrimin e rrezikut dhe raporton në Këshillin e Administrimit. Gjatë mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të datës 13 korrik 2010 u aprovuan disa politika të rëndësishme në përputhje me ligjin e ri nr. 10197. Këto politika përfshijnë Politikën e Investimeve, Politikën e Riskut dhe Politikën e Shërbimeve nga palë të treta.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Shoqëria, përmes standardeve dhe procedurave administrative, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrat e tij.

##### ***Politikat e investimit dhe performanca***

Shoqëria është e detyruar të investojë të paktën 50% të fondeve në aktive, të cilat janë përcaktuar nga Neni 38, i Ligjit Nr. 7943, “Për pensionet vullnetare dhe fondet private të pensioneve”.

Deri më 31 dhjetor 2010 Shoqëria i ka mbajtur investimet në bono thesari dhe obligacione të qeverisë shqiptare.

Politika e shpërndarjes së fitimeve është përcaktuar nga Ligji Nr. 7943, “Për pensionet vullnetare dhe fondet private të pensioneve”. Sipas kërkesave të nenit 39 të këtij ligji, Shoqëria kalon 5% të fitimit neto në rezervë, dhe shpërndan jo më shumë se 10% si dividend. Sipas këtij neni, vetëm 10% e fitimit i kalon aksionerëve, ndërsa fitimi i mbetur i kalon pjesëmarrësve në fond.

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

---

**4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(b) Rreziku i kreditimit**

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare nëse klienti apo pala tjetër që zotëron instrumentin financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga letrat me vlerë të mbajtura për tregtim si dhe nga llogaritë e arkëtueshme të tjera. Për qëllime të administrimit të rrezikut të kreditimit, Shoqëria konsideron të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kreditimit (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti dhe sektori).

Këshilli Mbikëqyrës ka deleguar përgjegjësitë për administrimin e rrezikut të kreditimit tek Drejtimi, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kreditimit. Investimet e Shoqërisë janë në bono thesari dhe obligacione të qeverisë shqiptare, kështu që Shoqëria nuk është shumë e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditimit.

Investimet në letra me vlerë sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë:

	<b>Letra me vlerë të tregtueshme</b>	
	<b>31 dhjetor 2010</b>	<b>31 dhjetor 2009</b>
Pa vonesa dhe të pazhvlerësuara		
Afatshkurtra: norma B4 (Shqipëria)	108,387,158	85,913,641
	<hr/>	<hr/>
<b>Vlera kontabël</b>	<b>108,387,158</b>	<b>85,913,641</b>
	<hr/> <hr/>	<hr/> <hr/>

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)***4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(c) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të jetë në gjëndje të shlyejë detyrimet financiare në kohën e duhur.

**Administrimi i rrezikut të likuiditetit**

Qëndrimi i Shoqërisë në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale, ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme, apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj. Tabela e mëposhtme paraqet flukset zbritëse të parave të detyrimeve financiare në bazë të maturitetit më të hershëm kontraktual, ose flukseve të pritshme.

	31 dhjetor 2010						
	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Jo-specifike	Totali
<b>Aktivet</b>							
Investime të mbajtura për tregtim	848,365	1,551,678	310,611	3,107,984	-	102,568,520	108,387,158
Parapagime dhe të arkëtueshme	-	-	243,751	41,520	-	-	285,271
Paraja dhe ekuivalentët e saj	2,838,955	-	-	-	-	-	2,838,955
<b>Totali</b>	<b>3,687,320</b>	<b>1,551,678</b>	<b>554,362</b>	<b>3,149,504</b>	<b>-</b>	<b>102,568,520</b>	<b>111,511,384</b>
<b>Detyrimet</b>							
Fondi i pensionit	-	-	-	-	-	66,261,587	66,261,587
Detyrime të pagueshme	384,146	999,144	-	-	-	-	1,383,290
<b>Totali</b>	<b>384,146</b>	<b>999,144</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>66,261,587</b>	<b>67,644,877</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>3,303,174</b>	<b>552,534</b>	<b>554,362</b>	<b>3,149,504</b>	<b>-</b>	<b>36,306,933</b>	<b>43,866,507</b>
<b>Kumulative</b>	<b>3,303,174</b>	<b>3,855,708</b>	<b>4,410,070</b>	<b>7,559,574</b>	<b>7,559,574</b>	<b>43,866,507</b>	<b>-</b>

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)***4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

	31 dhjetor 2009						
	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Jo-specifike	Totali
<b>Aktivet</b>							
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	-	546,059	-	85,367,582	85,913,641
Parapagime dhe të arkëtueshme	22,356	-	-	-	-	-	22,356
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5,510,309	-	-	-	-	-	5,510,309
<b>Totali</b>	<b>5,532,665</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>546,059</b>	<b>-</b>	<b>85,367,582</b>	<b>91,446,306</b>
<b>Detyrimet</b>							
Fondi i pensionit	-	-	-	-	-	53,215,538	53,215,538
Detyrime të pagueshme	288,373	2,619,630	-	-	-	-	2,908,003
<b>Totali</b>	<b>288,373</b>	<b>2,619,630</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>53,215,538</b>	<b>56,123,541</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>5,244,292</b>	<b>(2,619,630)</b>	<b>-</b>	<b>546,059</b>	<b>-</b>	<b>32,152,044</b>	<b>35,322,765</b>
<b>Kumulative</b>	<b>5,244,292</b>	<b>2,624,662</b>	<b>2,624,662</b>	<b>3,170,721</b>	<b>3,170,721</b>	<b>35,322,765</b>	<b>-</b>

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

---

**4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(d) Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kreditimit, do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë apo vlerën e instrumentave financiarë. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

***Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit***

Shoqëria nuk është ekspozuar dukshëm ndaj rrezikut të monedhës pasi transaksionet në monedhë të huaj nuk janë të shpeshta. Rreziku i monedhës është administruar duke përdorur parimin e përputhshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve dhe përmes kontributit të pronarëve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë shkëmbim të ardhshëm ose të ketë vendosur ndonjë transaksion për produkte derivative deri më 31 dhjetor 2010 dhe 2009.

Nuk ka mjete ose detyrime financiare të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2010 dhe 2009.

***Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit***

Rreziku kryesor ndaj të cilit janë të ekspozuara portofolet jo të tregtueshme është rreziku i luhatjeve të flukseve të ardhshme të parasë për shkak të ndryshimeve të normave të interesit të tregut (Pozicioni neto i vlerës aktuale të Aktiveve dhe Detyrimeve). Rreziku i normës së interesit administrohet nëpërmjet monitorimit të diferencave në normat e interesit.

Administrimi i rrezikut të normave të interesit mbështetet dhe nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve të Shoqërisë ndaj skenarëve të ndryshëm të interesave standarde dhe jo standarde. Skenarët standard të cilët merren në konsideratë në mënyrë të rregullt përfshijnë 100 pika bazë (bp) rënie, ose ngritje paralele në të gjitha normat e brendshme të kthimit.

Më poshtë është paraqitur analiza e ndjeshmërisë ndaj rënieve dhe ngritjeve të normës së interesit (duke marrë parasysh që s'ka lëvizje asimetrike në normën e kthimit dhe një pozicion financiar konstant):

<b>2010</b>	<b>Deri në 1 vit</b>		<b>Mbi një vit</b>	
	100 bp rritje	100 bp ulje	100 bp rritje	100 bp ulje
Ndikimi në fitim/(humbje)	109,793	(109,793)	(75,596)	75,596

  

<b>2009</b>	<b>Deri në 1 vit</b>		<b>Mbi një vit</b>	
	100 bp rritje	100 bp ulje	100 bp rritje	100 bp ulje
Ndikimi në fitim/(humbje)	55,579	(55,579)	(31,714)	31,714



## **Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

---

### **4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

#### **(e) Rreziku operacional**

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë, apo të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Shoqërisë, dhe nga faktorë të jashtëm siç janë kreditimi, tregu dhe rreziqet e likuiditetit që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregulluese si edhe nga standardet përgjithësisht të pranuar të sjelljes korporative, duke përfshirë rrezikun strategjik dhe të reputacionit.

Objektivi i Shoqërisë është të administrojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për të adresuar riskun operacional i caktohet Këshillit Mbikëqyrës. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesat për bashkërendimin dhe monitorimin e transaksioneve
- përputhja me kërkesat ligjore dhe rregullative
- dokumentim i kontrolleve dhe procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të rreziqeve operative të analizuara dhe përshtatshmërinë e kontrolleve e procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuar
- kërkesa për raportimin e humbjeve operative dhe veprimet rregullues të propozuar
- zhvillimi i planeve rastësore
- trainim dhe zhvillim profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- zvogëlim të rrezikut, duke përfshirë sigurim në rastet kur është efektiv.

### **5. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE**

#### *Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Në rastin e letrave me vlerë të tregtueshme vlera e drejtë është vlera e tregut. Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka çmime tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit të përshkruara në politikat kontabël 3(h).iii. Për instrumentet financiare që tregtohen jo në mënyrë të shpeshtë dhe kanë pak transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqëndrimit, pasigurisë të faktorëve të tregut, supozimeve të çmimit, dhe rreziqe të tjera që prekin instrumentin specifik.

#### *Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paranë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat rezidente. Sikurse këto gjendje janë afatshkurtër, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën e mbartur.

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

**5. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)**

*Investimet në letra me vlerë*

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Investimet në letrat me vlere janë mbajtur me vlerën e drejtë.

**6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

	<b>Automjete</b>	<b>Pajisje zyre dhe informatike</b>	<b>Totali</b>
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 1 janar 2009	2,583,000	1,681,109	4,264,109
Shtesa	-	39,344	39,344
Pakësime	(2,583,000)	-	(2,583,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>-</b>	<b>1,720,453</b>	<b>1,720,453</b>
Gjendja më 1 janar 2010	-	1,720,453	1,720,453
Shtesa	1,783,330	732,764	2,516,094
Pakësime			
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>1,783,330</b>	<b>2,453,217</b>	<b>4,236,547</b>
<i>Zhvlërësimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2009	1,370,712	944,963	2,315,675
Shpenzimi për vitin	131,332	191,228	322,560
Pakësime	(1,502,044)	-	(1,502,044)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>-</b>	<b>1,136,191</b>	<b>1,136,191</b>
Gjendja më 1 janar 2010	-	1,136,191	1,136,191
Shpenzimi për vitin	252,637	300,645	553,282
Pakësime			
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>252,637</b>	<b>1,436,836</b>	<b>1,689,473</b>
<i>Gjendja e mbartur</i>			
<b>Më 1 janar 2009</b>	<b>1,212,288</b>	<b>736,146</b>	<b>1,948,434</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>-</b>	<b>584,262</b>	<b>584,262</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>1,530,693</b>	<b>1,016,381</b>	<b>2,547,074</b>

Nuk ka aktive të vendosura si kolateral më 31 dhjetor 2010 (2009: zero).

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds  
Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

**7. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE**

	<b>Programe kompjuterike</b>
<i>Kosto</i>	
Gjendja më 1 janar 2009	230,550
Shtesa	50,350
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>280,900</b>
Gjendja më 1 janar 2010	280,900
Shtesa	7,240,728
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>7,521,628</b>
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>	
Gjendja më 1 janar 2009	48,193
Shpenzimi për vitin	51,532
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>99,725</b>
Gjendja më 1 janar 2010	99,725
Shpenzimi për vitin	45,288
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>145,013</b>
<i>Gjendja e mbartur</i>	
Më 1 janar 2009	<b>182,361</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>181,175</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>7,376,615</b>

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

**8. LETRA ME VLERË TË TREGTUESHME**

Investimet në letra me vlerë mund të detajohen si më poshtë:

<b>Të tregtueshme</b>	<b>31 dhjetor 2010</b>	<b>31 dhjetor 2009</b>
<b>Afatgjata</b>		
Obligacione qeveritare	102,568,520	85,367,582
	<b>102,568,520</b>	<b>85,367,582</b>
<b>Afatshkurtra</b>		
Bono thesari	5,818,638	546,059
Obligacione qeveritare	-	-
	<b>5,818,638</b>	<b>546,059</b>
<b>Totali</b>	<b>108,387,158</b>	<b>85,913,641</b>

Bonot e thesarit më 31 dhjetor 2010, i përkasin bonove me kupon zero të qeverisë shqiptare, me maturitet 3 muaj deri në një vit dhe normat e kthimit variojnë nga 6.45% në 8% në vit (2009: 8.95% në vit).

Obligacionet qeveritare më 31 dhjetor 2010 paraqesin obligacione qeveritare 2- vjeçare në monedhën e vendit të emetuara nga qeveria shqiptare me kupon që varion nga 9.46% në 9.55% dhe normë kthimi që varion nga 7.8% në 8% në vit; obligacione qeveritare 3 - vjeçare, të shprehura në monedhën e vendit , të emetuara nga qeveria shqiptare, me kupon 9.9% dhe normë kthimi që varion nga 7.1% në 9.55% në vit; obligacione qeveritare 7 - vjeçare të shprehura në monedhën e vendit të emetuara nga qeveria shqiptare me kupon 11% si dhe normë kthimi që varion nga 10% në 11.5% në vit (2009: Obligacione qeveritare 3 - vjeçare, të shprehura në monedhën e vendit , të emetuara nga qeveria shqiptare me kupon 9.9% dhe normë kthimi që varion nga 9.45% në 9.55% në vit; obligacione qeveritare 7- vjeçare, të shprehura në monedhën e vendit, të emetuara nga qeveria shqiptare me kupon 11% dhe normë kthimi që varion nga 10% në 11.5% në vit).

	<b>Vlera e tregut</b>	<b>(Skonto) / Prim i pa amortizuar</b>	<b>Interesa të përllogaritura</b>	<b>Totali i vlerës së drejtë</b>
Bono thesari	5,982,327	(163,689)	-	5,818,638
Obligacione qeveritare Afatgjata	100,617,778	834,764	1,115,978	102,568,520
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>106,600,105</b>	<b>671,075</b>	<b>1,115,978</b>	<b>108,387,158</b>

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

**8. LETRA ME VLERË TË TREGTUESHME (VAZHDIM)**

	Vlera e tregut	Skonto e pa amortizuar	Interesa të përlogaritura	Totali i vlerës së drejtë
Bono thesari	588,826	(42,767)	-	546,059
Obligacione qeveritare Afatgjata	84,948,615	(303,978)	722,945	85,367,582
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>85,537,482</b>	<b>(346,745)</b>	<b>722,945</b>	<b>85,913,641</b>

**9. PARAPAGIME DHE TË ARKËTUESHME**

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Debitorë të ndryshëm	41,520	22,356
<b>Totali</b>	<b>41,520</b>	<b>22,356</b>

**10. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ**

Paraja dhe ekuivalentet e saj janë mbajtur me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe përbëhen nga:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Llogari në banka në Lek	2,838,955	5,510,309
<b>Totali</b>	<b>2,838,955</b>	<b>5,510,309</b>

Llogaritë në banka në Lek janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
<b>Llogari rrjedhëse</b>		
Rezidente	78,760	310,309
	<b>78,760</b>	<b>310,309</b>
<b>Depozita</b>		
Rezidente	2,760,195	5,200,000
	<b>2,760,195</b>	<b>5,200,000</b>
<b>Totali</b>	<b>2,838,955</b>	<b>5,510,309</b>

Depozitat me bankat rezidente përbëhen nga depozita me maturitet 17 -20 ditor që fitojnë interes nga 2.5% ne 2.7% ne vit. (2009: depozitat me maturitet 7 ditor, interes vjetor nga 5.3% deri 6.1%).

# Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

## 11. KAPITALI AKSIONAR

Në bazë të Kontratës së shitjes, firmosur më 26 dhjetor 2008, Raiffeisen Bank Sh.a ka blerë 100% të aksioneve dhe është bërë aksioneri i vetëm i Shoqërisë. Raiffeisen Bank është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si aksioner i vetëm i Shoqërisë më 15 janar 2009. Raiffeisen Bank Sh.a. është regjistruar në Tiranë.

Më 31 dhjetor 2010 dhe 2009, kapitali aksionar është 90,000,000 Lek, i ndarë në 12,857 aksione me vlerë nominale prej 7,000 Lek secili. Struktura aksionare më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2010		31 dhjetor 2009	
	Në %	Në Lek	Në %	Në Lek
Raiffeisen Bank	100	90,000,000	100	90,000,000
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>90,000,000</b>	<b>100</b>	<b>90,000,000</b>

## 12. REZERVA LIGJORE

Më 25 Qershor 2010 Asambleja e Zakonshme e Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë, vendosi shpërndarjen e fitimit vjetor 2009 duke transferuar në rezervë ligjore shumën prej 1,000,000 Lek dhe duke kaluar pjesën tjetër të fitimit për mbulimin e humbjeve të mbartura.

## 13. FONDI I PENSIONIT

Lëvizjet e kontributeve të hyra dhe interesave të kredituar paraqitet si më poshtë:

	2010	2009
<b>Gjendja më 31 janar</b>		
Kontribute	39,420,560	33,314,145
Interesa ,	12,380,495	2,526,640
	<b>51,801,055</b>	<b>35,840,785</b>
<b>Lëvizjet gjatë periudhës</b>		
<i>Kontribute</i>		
Shtesa	14,694,032	12,023,356
Tërheqje nga anëtarët	(3,680,354)	(5,916,781)
	<b>11,013,678</b>	<b>6,106,415</b>
<i>Interesa</i>		
Kreditime për periudhën (shënimi 15, 16)	3,703,489	10,333,094
Tërheqje nga anëtarët	(1,373,472)	(479,239)
	<b>2,330,017</b>	<b>9,853,855</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor</b>		
Kontribute	50,434,238	39,420,560
Interesa	14,710,512	12,380,495
Diferenca nga rivlerësimi	1,116,837	1,414,483
	<b>66,261,587</b>	<b>53,215,538</b>

Më 31 dhjetor 2010, në Fond ka përafërsisht 1,771 anëtarë aktivë (2009: 1,630 anëtare).

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

**14. DETYRIME TË TJERA**

Detyrimet e tjera dhe parashikimet për detyrime dhe pagesa përbëhen si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2010</b>	<b>31 dhjetor 2009</b>
Shpenzime të përlogaritura auditimi	999,144	967,900
Detyrime për sigurimet shoqërore	168,551	164,064
Tatim mbi të ardhurat personale	108,323	81,605
Furnitorë	75,580	41,052
Detyrim ndaj Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare	31,092	11,176
Të tjera	603	1,850
<b>Totali</b>	<b>1,383,293</b>	<b>1,267,647</b>

**15. TË ARDHURA NGA LETRAT ME VLERË, NETO**

Të ardhurat nga interesat sipas kategorive përbëhen nga:

	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009</b>
Obligacione qeveritare	8,740,230	4,751,106
Bono thesari	259,573	283,111
Depozita dhe llogari rrjedhëse	70,070	118,366
<b>Të ardhura nga interesa të fituara gjatë periudhës</b>	<b>9,069,873</b>	<b>5,152,583</b>
Interesa që i kreditohen Fondit të Pensionit (shënimi 13)	(3,703,489)	(2,294,494)
<b>Totali</b>	<b>5,366,384</b>	<b>2,858,089</b>

**16. TË ARDHURA NGA TRANSAKSIONET, NETO**

	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009</b>
Të ardhura nga shit-blerja e të gjitha letrave me vlerë	34,433,817	40,175,008
<i>Të ardhura nga shit-blerja e letrave me vlerë të shoqërisë</i>	34,433,817	29,456,874
<i>Të ardhura të fituara nga letrat me vlerë të klientëve</i>	-	10,718,134
Interesa të kredituara fondit të pensionit (shënimi 13)	-	(8,038,600)
<b>Totali</b>	<b>34,433,817</b>	<b>32,136,408</b>

Gjatë vitit aktual Shoqëria ka kryer disa transaksione shit-blerjeje të portofolit të letrave me vlerë duke rritur në mënyrë të ndjeshme të ardhura nga transaksionet krahasuar me vitin e mëparshëm.

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

**17. SHPENZIMET PËR PERSONELIN**

Shpenzimet për personelin përbëhen si më poshtë:

	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009</b>
Paga dhe bonuse	13,199,734	8,248,107
Sigurime shoqërore	1,145,446	1,024,012
Kosto të tjera të personelit	313,022	242,432
<b>Totali</b>	<b>14,658,202</b>	<b>9,514,551</b>

Më 31 dhjetor 2010 Shoqëria ka të punësuar 9 punonjës (2009: 10).

**18. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE**

Shpenzimet e përgjithshme administrative përbëhen si më poshtë:

	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009</b>
Tarifë auditimi	1,291,550	2,684,754
Udhëtime dhe dieta	693,702	385,890
Shpenzime telefonike dhe internet	526,835	340,526
Punonjës të jashtëm	440,000	589,992
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	380,137	61,085
Publicitet, reklama	230,014	75,326
Shpenzime noteriale dhe ligjore	207,360	-
Të tjera	111,446	55,997
Kancelari	99,328	220,156
Taksa dhe gjoba	81,435	46,400
Riparime dhe mirëmbajtje	6,300	-
Shërbime komunale	-	6,582
<b>Totali</b>	<b>4,068,107</b>	<b>4,466,708</b>

Në bazë të Ligjit Nr. 9572 datë 23 korrik 2006 “Mbi autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe në Vendimin nr. 908, datë 29 dhjetor 2004, shoqëritë e pensioneve duhet të paguajnë një tarifë vjetore prej 1% të totalit të kontributit të përfituar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.



**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

**19. TATIM FITIMI**

Shoqëria ka përcaktuar tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Në vitin 2010, për shoqëritë shqiptare norma e tatimit është e barabartë me 10% (2009:10%) të të ardhurave të tatueshme.

Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit mbi fitimin i përlogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Fitimi përpara tatimit	19,687,036	21,373,537
Tatim fitimi i përlogaritur me 10%	1,968,703	2,137,354
Efekti tatimor i shpenzimeve të pazbritshme	16,342	13,000
<b>Tatim fitimi</b>	<b>1,985,045</b>	<b>2,150,354</b>

**20. PARASHIKIME DHE ANGAZHIME**

Më 31 dhjetor 2010 dhe 2009, Shoqëria nuk është e përfshirë në kërkesa dhe procedura ligjore.

**21. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

Palë e lidhur konsiderohet një entitet nëse (direkt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala (i) kontrollon, kontrollohet është nën kontroll të përbashkët, entiteti (ii) ka një interes në entitetin që ka një ndikim të ndjeshëm mbi entitetin; (iii) ka një kontroll të përbashkët mbi entitetin (b) pala është një partnere e entitetit; (c) pala është në një pjesëmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është një sipërmarrës; (d) pala është një anëtare kyçe e administrimit të shoqërisë ose shoqërisë mëmë; (e) pala është një anëtare e afërt e familjes të individit të sipërpërmendur në (a) ose (d); (f) pala është entitet që kontrollohet, kontrollohet bashkarisht ose influencohet, ose për të cilën ruan fuqinë më të madhe të votimit, direkt apo indirekt për çdo individ të referuar në (d) ose (e) ose (g) pala është një plan përfitimi pas-punësimit në dobi të punonjësve të njësisë.

Një transaksion me një palë të lidhur është transferim burimesh, shërbimesh ose detyrimesh nëpërmjet palëve të lidhura, pavarësisht nga çmimi i faturuar.

**Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a**

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(shumat në Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)

**21. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)**

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me shoqërinë mëmë Raiffeisen Bank sh.a. Më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 njësia ka hyrë në transaksionet e mëposhtme dhe balanca me palët e lidhura:

	<b>2010</b>	<b>2009</b>
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>		
Paraja dhe ekuivalentër e saj	2,838,955	5,399,154
<b>Totali</b>	<b>2,838,955</b>	<b>5,399,154</b>
<b>Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave</b>		
<b>Të ardhura</b>		
Të ardhura nga transaksionet	34,433,817	40,175,008
Të ardhura neto nga komisionet	24,550	113,650
<b>Shpenzime</b>		
Pagesa për drejtimin	6,790,156	2,806,400
<b>Totali</b>	<b>27,668,211</b>	<b>37,482,258</b>

**22. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim, ose prezantim në pasqyrat financiare.